

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit “Oti Com” sh.p.k., me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim F.P., avokat nga Prishtina, kundër të paditurit “Eurometal” sh.p.k., me seli në Ferizaj, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor N.M., për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr.558/13, të datës 14.09.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.07.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET, si e pabazuar ankesa e paditësit “Oti Com” sh.p.k., me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr.558/13, i datës 14.09.2016, **VËRTETOHET**

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr.558/13, të datës 14.09.2016, në pikën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesë e paditësit “Oti Com” sh.p.k., me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet i padituri “Eurometal” sh.p.k., me seli në Ferizaj, që në emër të kompensimit të dëmit, t’ia paguaj shumën prej 7.410.00 €, me kamatë prej 8% në vit, duke e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, ndërsa në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr.558/13, i datës 14.09.2016, në pikën I të dispozitivit të ndryshohet ashtu që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar ose aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet në riprocedurë dhe rivendosjen dhe në pikën II të detyrohet i padituri që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore për ankesë, për taksë gjyqësore, për ekspertizë ndërtimore të ekspertit Selman Boqolli, përgjigje në padi, për përfaqësim të avokatit në seanca gjyqësore si dhe shpenzimet tjera sipas tarifës së avokatëve të Kosovës.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Paditësi “Oti Com” sh.p.k., me seli në Prishtinë, me datë 10.10.2013, ka paraqitur padi kundër të paditurit “Eurometal” sh.p.k., me seli në Ferizaj dhe ka kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurin që paditësit t’ia kompensoi dëmin në shumë prej 7.410.00 €, me kamatë prej 8% në vit.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, paditësi dhe i padituri kanë qenë në raport juridiko-civil nga kontrata mbi punën e lidhur më datë 18.01.2011. Sipas kontratës i padituri ka marrë detyrimin që të punoj kulmin në objektin e paditësit me konstruksion prej çeliku dhe mbulimin e të njëjtit me llamarinë të plastifikuar TR 33 me file dhe elemente përcjellëse. Paditësi dhe i padituri janë dakorduar që vlera e punimeve të kryera të kompensohet me banesë në lagjen Kalabria-Prishtinë. Çmimi për 1 m² është përcaktuar në shumën prej 800 € dhe në rast se vlera e banesës e tejkalon vlerën e punimeve të kryera, i padituri t’i paguajë diferencën paditësit. Nga fletë-kompensimi i nënshkruar nga palët ndërgjyqëse ka rezultuar se vlera e punimeve të kryera ka qenë në shumën prej 71.610.00€, pagesat janë mbyllur me faturime të ndërsjellta dhe të rregullta. Vlera e përgjithshme e punimeve të kryera në banesë, është në shumën prej 71.610.00€ dhe çmimi i shitjes së banesës është konvertuar në vlerën e punimeve të kryera nga i padituri. Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të ndërtimtarisë Selman Boçolli, të dhënë me datën 30.03.2016, rezulton se punët prej konstruksionit metalik dhe mbulesës të kryera në kulmet e objekteve banesore I,II dhe III, në lagjen “Kalabria” në Prishtinë, të kryera nga i padituri “Eurometal” sh.p.k., me seli në Ferizaj, janë kryer sipas kontratës së punës, me kualitet dhe sipas rregullave teknike dhe sipas standardeve ndërtimore. Sa i përket olluqeve vertikale eksperti ka deklaruar se ato nuk janë të lidhura me sistemin e drenazimit, sepse kjo nuk ka qenë e përcaktuar me projekt dhe edhe po të ishin të vendosura deri tek podrumi, lidhja me rrjetin e drenazimit ka qenë e pa mundur sepse objekti nuk posedon fare drenazhin. Sa i përket pretendimeve të paditësit për dëmet e shkaktuara, eksperti ka deklaruar se nuk ka asnjë shënim zyrtar na asnjëra palë kontraktuese, ku është konstatuar ndonjë vërshim apo rrjedhje uji që kishte me shkaktuar dëme materiale, përveç 5 fotove të prezantuara nga paditësi. Asnjë procesverbal as dokument nga organi kompetent komunal-Inspekcioni i Ndërtimit, nuk është konfirmuar rasti i dëmeve të shkaktuara nga rrjedhja e ujit apo shkaku tjetër. Poashtu eksperti në sqarimet e dhëna në seancën dëgjimore të datës 13.09.2016, ka deklaruar se i padituri si punëkryerës nuk ka bërë shkeljen e rregullativës së ndërtimit apo të projekteve.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar dhe në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në shumën prej 7.410.00 €, pasi ka vlerësuar se nuk ekziston detyrimi i të paditurit për kompensimin e dëmeve të pretenduara nga paditësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm lidhur me të gjitha pikat e dispozitivit të aktgjykimit, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale për shkak se, nga provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk është vërtetuar lidhja shkakore ndërmjet veprimeve të së paditurës dhe dëmit eventual të pësuar nga paditësi. Andaj nuk mund të obligohet pala e paditur për kompensimin e një dëmi të cilin nuk e ka shkaktuar.

Në këtë gjendje të vërtetuar faktike, kjo gjykatë konsideron se nuk ekziston obligimi i së paditurës që paditësit t' ia paguajë kompensimin e kërkuar, nga arsyeja se paditësi me asnjë provë nuk e ka provuar dëmin dhe faktin se ai është shkaktuar nga veprimet apo lëshimet e të paditurës. Këtë qëndrim gjykata e mbështet në dispozitat e Neneve 319.1 dhe 322.2 të LPK-së, të cilët parashohin se pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë ta provojë faktin që është qenësor për realizimin e asaj të drejtë ndërsa në rastin konkret edhe pse paditësi në bazë të dispozitave të sipërcituara e ka pasur barrën që ta provojë se më të vërtet ka pësuar dëm si pasojë e lëshimeve të së paditurës, ai me asnjë provë nuk e ka dokumentuar dëmin e pësuar si dhe lartësinë e tij.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të paditësit lidhur me caktimin e ekspertit nga ana e gjykatës, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka bërë caktimin e ekspertit të propozuar nga pala paditëse. Me aktvendimin e datës 08.12.2015, për punimin e ekspertizës së ndërtimitarisë, ka caktuar ekspertin gjyqësor Skender Canolli, mirëpo me parashtresën e datës 14.01.2016, eksperti në fjalë e ka njoftuar gjykatën se nuk mund ta kryejë lëndën sepse lënda e caktuar ka të bëjë me vlerësimin e një konstruksioni metalik të pullazit dhe pasi që nuk është i profilizuar për konstruksione metalike, ka propozuar që të autorizohet një inxhinier i profilizuar për këtë lëmi. Andaj me vendimin e datës 15.01.2016, gjykata e shkallës së parë ka caktuar ekspertin gjyqësor Selman Boçolli.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, përkatësisht neni 366 par. 1 dhe 2, sepse konstatimi i ekspertit nuk ka mangësi ose paqartësi dhe konstatimi dhe mendimi i ekspertit i është paraqitur gjykatës në mënyrë të plotë dhe të qartë dhe i njëjti mbështete në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,

Ae.nr.244/2016,dt. 04.07.2017

KRYETARI I KOLEGJIT,

Mahir Tutuli,d.v.